

# PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

*Newsletter*

## ÇËSHTJET KRYESORE

Fq. 2 | Roli i gjuetarëve në mbrojtjen e rrëqebullit të Ballkanit dhe gjahut të tij

Fq. 3 | Rrëqebulli i Ballkanit në zemër të fushatës "Shqipëria është Biodiversitet" në Tiranë

Fq. 4 | Takimi LIFE Lynx / Eurolynx në Kroaci

Fq. 5 | Fotografohet për herë të parë dhia e eger e Ballkanit (*Rupicapra rupicapra balcanica*) në Malin e Thatë, pjesë e Parkut Kombëtar të Liqenit të Prespës

Fq. 6 | Palët e interesit takohen me Ekspertët e LCIE

Fq. 7 | Ripyllëzimi i Parkut Natyror të Munellës, një nismë për t'i dhënë shpresë llojit të rrezikuar në mënyrë kritike për zhdukje, e rrëqebullit të Ballkanit



## NË RRUGËN E DUHUR - NE JEMI GATI PËR VITIN 2024!



# ROLI I GJUEJARËVE NË MBROJTJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT DHE GJAHUT TË TIJ

Nga  
*Melitjan Nezaj, Bledi Hoxha, Klaudja Koçi, Ilir Shyti*

Tashmë është e ditur se ruajtja e rrëqebullit të Ballkanit, këtij lloji madhështor dhe preut të tij, janë të një rëndësie të madhe për mbajtjen e ekuilibrit ekologjik në rajonin e Ballkanit. Ndërsa përpjekjet për ruajtjen e tij shpesh lidhen me organizatat për mbrojtjen e jetës së egër dhe organet qeveritare, gjuetarët gjithashtu luajnë një rol vendimtar në ruajtjen e llojeve të egra.

Praktikat e qëndrueshme të gjuetisë janë integrale për ruajtjen jo vetëm të llojeve të gjahut, por edhe atyre jo objekt gjuetie, duke përfshirë këtu edhe rrëqebullin e Ballkanit. Gjuetarët janë aktorët kryesorë në promovimin e praktikave të qëndrueshme të gjuetisë, pasi ata kanë interes të sigurojnë që aktivitetet e tyre të mos ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë afatgjatë të popullatave të kafshëve të egra. Për më tepër, njohuritë e tyre mbi popullatat, kontribuojnë në vendimmarrje, në lidhje me kuotat dhe sezonet e gjuetisë, duke mbështetur më tej praktikat e qëndrueshme të gjuetisë.

Shoqatat e gjuetarëve në territoret e rrëqebullit shërbejnë si avokatë të rëndësishëm për përmirësimin e ligjeve dhe rregulloreve të gjuetisë për t'u ndërlidhur më mirë me qëllimet e ruajtjes.

Duke njohur rëndësinë e përpjekjeve bashkëpunuese në ruajtjen e jetës së egër, gjuetarët kërkojnë në mënyrë aktive partneritete me OJQ-të e dedikuara për mbrojtjen e biodiversitetit. PPNEA ka krijuar tashmë një bashkëpunim afatgjatë me Federatën Shqiptare të Gjuetarëve.

Takimi, i organizuar në Tiranë në datën 18 Shtator 2023, synonte krijimin e një marrëdhënieje bashkëpunimi midis PPNEA-s dhe shoqatave të gjuetarëve. Më shumë se 60 përfaqësues nga shoqatat e gjuetarëve në rajonet e Shkodrës, Kukësit, Lezhës, Elbasanit dhe Korçës me rëndësi të lartë të pranisë së rrëqebullit në Shqipëri morën pjesë në takim. Objektivi kryesor ishte promovimi i mbështetjes dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet tyre. Ky partneritet do të sigurojë mbrojtjen e popullatës së rrëqebullit, ruajtjen e habitateve dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Këto dy institucione ndajnë disa interesa në territoret e rrëqebullit. Kjo përfshin promovimin e praktikave të përgjegjshme të gjuetisë, eko-turizmit dhe edukimin e komuniteteve lokale për rëndësinë e veçantë të rrëqebullit dhe habitateve të tij. Si shoqatat e gjuetarëve ashtu edhe PPNEA mund të punojnë së bashku për të monitoruar popullatën e rrëqebullit dhe për të kryer studime gjenetike më të thelluara. Ata kërkojnë zbatimin e rregulloreve të gjuetisë, krijimin e zonave të mbrojtura dhe ndjekjen penale të rasteve të gjuetisë së paligjshme.





## RRËQEBULLI I BALLKANIT NË ZEMËR TË FUSHATËS "SHQIPËRIA ËSHTË BIODIVERSITET" NË TIRANË

*Nga Klaudja Koçi & Lorena Pyze Xhafaj*

Çdo ditë, prej datës 3 deri më 21 tetor, për tre javë me rradhë, PPNEA tërhoqi vëmendjen e qytetarëve shqiptarë dhe vizitorëve të huaj në Tiranë, nëpërmjet një instalacioni shumë të madh të vendosur në sheshin "Skënderbej". Mozaiku "Shqipëria është Biodiversitet" i konceptuar nga artisti i mirënjohur ndërkombëtar Kadir Özmen dhe dizenuar nga Kledi Eski, përfshiu 38 nga llojet shqiptare më të rrezikuara dhe karizmatik, me në qendër llojin emblematik të rrëqebullit të Ballkanit. I rrethuar nga "kullat informuese" dedikuar shpendëve dhe gjitarëve, mozaiku tërhoqi vizitorët tek këndi i edukimit dhe informimit, si dhe tek një zonë e vogël për blerje.

Specialistja e edukimit e PPNEA, Klaudja Koçi, dizenoi veçanërisht për këtë fushatë të gjerë, një program edukimi me aktivitete të shumta interaktive rreth rrëqebullit të Ballkanit, kalit të qyqes dhe llojeve të tjera të rrezikuara. Turi i edukimit ishte një aktivitet eksperimental që i bëri nxënësit e shkollave pjesë të një rrugëtimi të shkurtër ore edukative, duke mësuar rreth karakteristikave të rrëqebullit të Ballkanit, ekologjisë së tij, kërcënimeve, të ilustruara nëpërmjet rrëqebullit në madhësi reale 2D dhe preut të tij, një statujë 3D rrëqebulli, rikrijimit të gjurmës sipas modelit real, tregimit të historisë së "Shpresës, rrëqebullit të Ballkanit" dhe videove nga kamerat kurth.

Më tepër së 900 fëmijë nga shkollat fillore dhe të mesme morën pjesë në këtë program, nga 17 shkolla të qytetit të Tiranës. Një kombinim midis edukimit dhe lojës, ky kënd i mbajti vizitorët e rinj gjithnjë aktiv dhe të argëtuar.

Ky kënd solli gjithashtu së bashku rreth 100 studentë pjesëmarrës në 4 evente të dedikuara për ta, të fokusuar tek rrëqebulli i Ballkanit dhe menaxhimi i korridoreve ekologjike. Diskutimet aktive me ekipin e BLRP-së nga PPNEA, si dhe ekspozitave me fotografi dhe pajisjeve monitoruese, sollën një perspektivë të re për sa i përket këtij lloji të rrezikuar në mënyrë kritike, duke u bazuar në studimet e fundit që ndihmuan për të kuptuar statusin e tij, arritjeve të programit dhe sfidave për ruajtjen.

Fushata "Shqipëria është Biodiversitet" është një nismë e përbashkët mes Qendrës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Heinrich Böll Stiftung Tirana, e mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, Delegacioni i Bashkimit Europian, Ambasada Gjermane në Shqipëri, Ambasada Franceze në Shqipëri, AICS Tirana dhe Vodafone Albania, për edukimin dhe ruajtjen e llojeve më të veçantë dhe të rrezikuara të Shqipërisë, si dhe pasurive natyrore të vendit tonë.

# TAKIMI LIFE LYNX / EUROLYNX NË ZADAR, KROACI

*Nga Aleksandar Pavlov*

Takimi i shumë ekspertëve të rrëqebullit sjell gjithmonë kënaqësi. Takimi u mikprit në qytetin e Zadarit, një vend piktoresk i cili ishte një vlerë e shtuar e një përvoje katër ditore.

Dy ditët e para (26-27 shtator), ishin të dedikuara për zhvillimin e Konferencës Ndërkombëtare të Lifelynx. Me temën “Së bashku për Rrëqebullin” ky event mbledhi ekspertë të shumtë nga vende të ndryshme të Evropës dhe Gadishullit të Ballkanit që punojnë për mbrojtjen e rrëqebullit. Ne u njohëm me rezultatet dhe arritjet për mbrojtjen dhe përforsimin e popullatës së rrëqebullit të Alpeve Dinarike Dinaric SE Alpine lynx population. Temat varionin nga historiku i statusit të rrëqebullit, aspektet ekologjike, trajtimi i përshtatshmërisë dhe lidhjes së habitatit, ruajtja, menaxhimi dhe komunikimi, deri te erozioni gjenetik dhe përforsimi i popullsisë. Përveç pjesës teorike pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë Parkun Kombëtar Paklenica, i njohur për përforsimin gjenetik të popullatës së rrëqebullit të Karpateve.

Dy ditët e tjera (28 dhe 29 shtator), po në të njëjtin vend, u organizua takimi i 5-të i Eurolynx, me kolegë të vjetër dhe të rinj, të gjithë ekspertë me një mision të përbashkët, atë të diskutimit rreth kërkimeve shkencore dhe risive mbi rrëqebullin.

Këtu, edhe një herë, ne pamë dhe ndjemë përfitimet e të qenit anëtar i një komuniteti ekspertësh të jashtëzakonshëm, që promovon shkencën në mënyrë bashkëpunuese, me 51 anëtarë nga 21 vende të ndryshme.



Meqenëse shumica e studiuesve evropianë të rrëqebullit janë tashmë pjesë e këtij rrjeti, ne patëm mundësinë për të mësuar mbi kërkimet më të fundit në ekologjinë e lëvizjes së rrëqebullit në Evropë dhe për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit shkencor.

Në përgjithësi, ekipi i BLRP ishte i emocionuar që ishte pjesë e këtyre dy ngjarjeve, pasi ata ofruan një forum për ndarjen e njohurive, diçka që do të shërbejë si udhëzues ndërsa po hapim një kapitull të ri të Programit të Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit, duke u fokusuar në aspektet gjenetike të këtij lloji.



# FOTOGRAFOHET PËR HERË TË PARË DHIA E EGËR E BALLKANIT (RUPICAPRA RUPICAPRA BALCANICA) NË MALIN E THATË, PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË LIQENIT TË PRESPËS

Nga

*Bledi Hoxha, Adnand Bego, Emir Gjyzeli, Klaudja Koçi, Melitjan Nezaj, Ilir Shyti, Aleksandër Trajçe*

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe AdZM Korçë, realizuan monitorimin e përbashkët të dhisë së egër, më datë 1 Nëntor 2023, në Malin e Thatë. Gjatë ekspeditës, u realizua për herë të parë vërtetimi dhe fotografimi i dhisë së egër në pjesën verilindore të Malit të Thatë, në një lartësi 2044 m mbi nivelin e detit.

Vërtetuesit arritën të identifikojnë një tufë të vogël dhish të egra, të përbërë nga 4 individë të maturuar (1 individ mashkull dhe 3 femra). Këto të dhëna tregojnë se në habitatet e Malit të Thatë jeton një popullatë e vogël e dhisë së egër e cila gjen kushte të përshtatshme për strehim dhe riprodhim. Duke marrë parasysh ekologjinë e llojit, i cili është aktiv kryesisht gjatë ditës në mëngjes dhe pasdite, vërtetimi dhe fotografimi i dhisë së egër ndodhi herët në mëngjes. Gjithashtu, stina e vjeshtës, është periudha më e përshatshme për monitorimin e dhisë së egër pasi përkon me sezonin e riprodhimit e cila të jep mundësinë për të grumbulluar më shumë të dhëna rreth strukturës brenda një popullate të dhisë së egër. Masivi malor i Malit të Thatë në Shqipëri dhe Galiçicës në Maqedoninë e Veriut, përmban habitate të rëndësishme si kullota Alpine dhe terrene të thyera shkëmbore të domosdoshme për llojin për tu ushqyer dhe strehuar gjatë stinëve të ndryshme të vitit.

Dhia e egër është e mbrojtur nga legjislacioni shqiptar e klasifikuar me status Vulnerabël në Listën e Kuqe të Florës dhe Faunës në Shqipëri. Prezenca dhe mbrojtja e mëtejshme e saj dhe habitatit në Parkun Kombëtar të Prespes, do të ndikojë pozitivisht në rimëkëmbjen e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit si një nga llojet pre kryesore të këtij mishngrënësi.

Realizimi me sukses i vërtetimit të dhisë së egër në Malin e Thatë u arrit hap pas hapi duke kaluar në të gjitha proceset e monitorimit, duke filluar nga hartimi i një protokollit të unifikuar për monitorimin e dhisë së egër në nivel ndërkuftar dhe trajnimeve teorike dhe praktike të realizuara nga Shoqata e Dhisë së Egër në Greqi. Kapacitetet e ngritura të grupit kërkues pranë PPNEA-s, AdZM Korçë dhe stafit të Parkut të Galiçicës nga projekti PONT, do të shërbejnë për organizimin e monitorimeve të përbashkëta ndërkuftare me qëllim grumbullimin e të dhënave të cilat do të ndikojnë në marrjen e masave të mëtejshme në mbrojtjen dhe menaxhimin e kesaj popullate. Gjithashtu, monitorime të tjera për evidentimin e dhisë së egër në zonat ku rrëqebulli i Ballkanit është i pranishëm, si Polis-Valamarë dhe rajoni i Munellës, janë parashikuar të ndodhin gjatë vitit 2024.



# PALËT E INTERESIT TAKOHEN ME EKSPERTËT E LCIE

*Nga Dime Melovski*

Nisma Europiane për Karnivorët e Mëdhenj (LCIE) është një rrjet i krjuar nga ekspertë dhe studiues të karnivorëve të mëdhenj nga e gjithë Evropa. Që prej vitit 1995, kur LCIE u themelua, ka pasur një rritje graduale dhe aktualisht është shtrirë në mbi 32 shtete Europiane duke përfshirë 55 anëtarë. Që prej vitit 2010, statusi i LCIE ka ndryshuar në Grup Ekspertësh pjesë e Komisionit për Mbijetesën e Llojeve (SSC) të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Këtë vit, takimi vjetor i LCIE u organizua në Ohër, Maqedoninë e Veriut. Një mundësi e shkëlqyer për ekipin e rrëqebullit të Ballkanit për të ftuar palët e interesit nga të tre vendet dhe të tregonin për statusin e vështirë gjenetik të rrëqebullit të Ballkanit si dhe nevojës për përforsimin e popullatës së tij. Anëtarë nga Ministrinë e Pyjeve dhe Mjedisit, Federatat e gjuetarëve, Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura si dhe Parku Kombëtar “Mavrovë” (Maqedoni e Veriut) dhe “Bjeshkët e Nemuna” (Kosovë) patën mundësinë për të diskutuar rreth çështjeve të karnivorëve të mëdhenj me të cilat përballen ekspertët nga rajoni. Përveç planit për përforsimin e popullatës së rrëqebullit dhe kërcënimit prej riprodhimit midis llojit, ne prezantuam rreziqet me të cilat po përballen popullatat e ujkut dhe ariut, në pjesën jugperëndimore të Ballkanit. Më specifikisht, statusi ligjor jo i favorshëm i ujkut në Maqedoninë e Veriut është një tematikë e tejzgjatur e cila duhet të ndryshojë shumë shpejt pasi ka indikacione që popullata është në rënie.



Ndryshe nga kjo, popullata e ariut në Maqedoninë e Veriut, me shumë mundësi është në rritje dhe në kombinim me përhapjen e ushqimit gjatë këtij viti, ka shkaktuar që arinjtë të lëvizin drejt fshatrave malorë dhe të shkaktojnë frikë dhe rrëmujë.

Adresimi i këtyre çështjeve ishte i një rëndësie të madhe për palët e interesit në mënyrë që të kenë një perspektivë më të mirë për ekzistencën e mundësive për menaxhimin e kësaj situate nëpërmjet vendeve të tjera Europiane.

Në përgjithësi, takimi ishte i suksesshëm jo vetëm për anëtarët e LCIE për të finalizuar programin vjetor, por edhe për ekipin e rrëqebullit të Ballkanit për të njohur ekspertët dhe përfaqësuesit të cilët punojnë për ruajtjen dhe menaxhimin e natyrës në vendet e rajonit.





## RIPYLLËZIMI I PARKUT NATYROR TË MUNELLËS, NJË NISMË PËR T'I DHËNË SHPRESË LLOJIT TË RREZIKUAR NË MËNYRË KRITIKE PËR ZHDUKJE RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

*Nga Xhemal Xherri, Ilir Shyti*

Në kuadër të fushatës për të luftuar shpyllëzimin dhe për të mbrojtur llojet e faunës dhe florës, një grup të rinjsh, në koordinim me ekspertët e PPNEA, janë mbledhur sërish, si çdo vit për të vazhduar ripyllëzimin e Parkut Natyror Munellë dhe bio-korridoret lidhëse si, Parku Kombëtar Alpet Shqiptare, Parku Natyror Korab-Kortinik, Iballë-Flet dhe Skavica. Kjo nismë ka një mision fisnik për të rimëkëmbur ekosistemet duke mbjellë pemë vendase si dhe duke krijuar një mjedis të qëndrueshëm për jetën e egër, veçanërisht për llojet e rrezikuara në mënyrë kritike, si rrëqebulli i Ballkanit.

Më 23 dhjetor 2023, banorët vendas, vullnetarë, së bashku me organizatat mjedisore dhe mbështetjen e institucioneve si Bashkia Fushë-Arrëz dhe AdZM-të përkatëse, do të bashkojnë forcat për të nisur me aksionin e mbjelljes së rreth 3500 pisha (*Pinus nigra* Arn.) në zonat e degraduara të Parkut Natyror të Munellës dhe rreth 200 arra (arra dhe gështenja të zonës) pranë zonave të banuara në koordinim me komunitetin vendas. Fushata do të ndahet në disa aksione, të cilat do të zbatohen përgjatë muajve janar dhe shkurt.

Rajoni i Munellës dhe rrethinat e saj janë përballur me kërcënime të ndryshme gjatë dekadës së fundit, për shkak të aktiviteteve njerëzore dhe aktivitetit të mbishfrytëzimit. Kërcënimet kryesore janë të përqendruara në prerjet e paligjshme dhe gjuetinë pa leje, mbikullotjen si dhe zjarret e qëllimshme.

Dëme të tilla llogariten në mijëra hektarë pyje të degraduar që përbëjnë rrezik për vetë sistemin natyror dhe jëten e egër që jeton në këtë zonë. Veç kësaj, fenomene të tilla paraqesin një rrezik të madh për komunitetet lokale, duke humbur lëndën drusore si dhe rritjen e erozionit të lartë malor që rrit rrezikun e dëmtimit natyror dhe ndikimin negativ në mikroklimëm e zonës.

Kjo nismë është një shpresë për rimëkëmbjen e rajonit të Munellës, shpresë për rimëkëmbjen e llojeve të rrezikuara, si rrëqebulli i Ballkanit si dhe një nxitje për të zhvilluar eko-turizmin, e për të krijuar një jetesë të qëndrueshme.



---

# PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

## Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

“Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” (BLRP) është një iniciativë e përbashkët që implementohet nga Fondacioni EuroNatur, KORA (Shoqata e Ekologjisë së Mishngrënësve dhe Menaxhimi i Jetës së Egër në Zvicër), MES (Shoqata Ekologjike Maqedonase), PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri) dhe ERA (Grupi i Veprimit me Përgjegjësi Mjedisore).

Informacion shtesë:  
<https://www.facebook.com/balkanlynx>



Environmentally  
Responsible  
Action



**PPNEA**

PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA  
• SINCE 1991 •



MACEDONIAN  
ECOLOGICAL  
SOCIETY



RAUBTIERÖKOLOGIE UND WILDTIERMANAGEMENT

# euRONATUR